Mediçëve nga qyteti i lindjes, i përpjekjeve të Savonarolës dhe i mbarimit të tij tragjik. Makiaveli del në shesh dhe njihet kur merr pjesë si nëpunës në qeverinë e vendit. Ndoshta, duke mos mundur të jetonte me të ardhurat e tij të pakta, më 1498-n mori pjesë në një konkurs për sekretar të kancelarisë së dytë të Zotërinjve (Signoris-ë) dhe, si fitoi, u ngarkua me detyrën e sekretarit në zyrën e të Dhjetëve. E mbajti këtë shkallë gjer më 1512-n, në kohën kur Mediçët morën përsëri fuqinë në Firence. Në atë punë, ai ishte ngarkuar me letërkëmbimin politik, me regjistrimin e vendimeve të këshillit, që përbënte pushtetin ekzekutiv të republikës, me redaktimin e traktateve dhe me pjesën më të madhe të marrëdhënieve diplomatike. Duket se Pier Soderini, që më 1502-shin qe bërë gonfalonier i përhershëm (detyrë që sot i përngjan pak a shumë presidentit të republikës), e çmonte shumë Makiavelin, sepse kur dërgonte fisnikë fjorentinë me detyra diplomatike jashtë shtetit, u jepte me vete edhe atë, tek i cili kishte besim të plotë. Gjatë asaj kohe, Makiaveli kreu njëzet e tre misione jashtë shtetit, si në Francë, pranë Luigjit XII, në Gjermani e gjetkë. Në një nga këto misione, pati rastin të njihete dhe Qezar Borxhian, i cili e preku thellë me virtytin¹² dhe gjallërinë e tij, sa që e bëri Makiavelin ta quante hero dhe t'ua tregonte si model të princit të përsosur, princërve të tjerë. Ai ishte dërguar si komisar edhe pranë ushtrive mercenare, që Franca mbante me shpenzimet e veta për të nënshtuar qytetin rebel të Pizës. Kështu, pati rastin ta njihete për së afërmi këtë ushtri, t'i kuptonte të metat dhe të bindte qeverinë të krijonte një ushtri të rregullt, e cila u quajt "Ordinanca Fjorentine". Koha në të cilën Makiaveli zhvilloi veprimtarinë e tij si sekretar i të Dhjetëve, ka qenë nga më të hidhurat e nga më të vështirat e Italisë, sepse në këtë periudhë, ajo u shkel e u përshkua nga çdo anë, nga frëngjit, spanjollët, zviceranët e gjermanët. Asnjë nga shtetet italiane nuk ishte në gjendje t'u bënte ballë vërshimeve të tyre. Ushtritë mercenare, që përdornin këto shtete, u treguan të dobëta për t'iu bërë ballë të huajve. Makiaveli, që shihte kthjellët, vuri re se shkaku i këtyre fatkeqësive ishte mungesa e një shteti të fortë e të madh italian dhe çorganizimi ushtarak. Më 1512-n kardinali Gjon i Mediçëve, që pak më pas do të bëhej papë Leoni X, me ndihmën e një ushtrie spanjolle, bëri

¹² Fjala virtyt këtu, dhe në përgjithësi në libër, nuk ka askund kuptimin e moralit e të etikës, si për skolastikët; as si zotësi ushtarak, në kuptimin e romakëve. Ajo ka kuptimin, sipas mendësisë së rilindësve, si zotësi, inteligjencë, kurajë, forcë, aftësi, shkathësi, intuitë, ndjeshmëri e individit që di t'i dallojë rastet e volitshme, që njeh mundësitë e veta dhe që përdor masa në përputhje me to. Virtyti është zotësi me anë të së cilës njeriu shkon i patrembur drejt qëllimit, i zhveshur nga çdo ndjesi tjetër.

të mundur rrëzimin e qeverisë në Firence dhe hyrjen e Mediciëve në të. Kështu, Pier Soderini ra dhe hipi në fuqi Sinjoria e Mediciëve. Makiaveli, që mbeti gjer në fund besnik i Soderinit dhe i Republikës, u shkar-kua nga detyra si sekretar, u burgos dhe u torturua për disa muaj, i dyshuar për një komplot kundër Mediciëve. Doli nga burgu me amnis-tinë që bëri Gjoni kur u zgjodh papë, por u detyrua të banonte në Shën Kashano, në rrethinat e Firences, ku kishte një shtëpi dhe një copë tokë. Larg nga veprimtaria politike dhe i ndarë nga rrethi, nga i cili kishte jetuar gjer atëherë, shkonte këtu një jetë monotone e të mërzitshme, sikundër shihet në letrën që i drejton Françesk Vetorit. I vetmi ngushë-llim për të ishte leximi i klasikëve, prej të cilëve nxirrte mësim, të cilat donte t'ia përshtaste Italisë së atëhershme të copëtuar dhe, pjesërisht, në duar të të huajve. Këtu i ra ndër mend krijimi i një shteti të fortë italian me ushtri të rregullt kombëtare që t'u bënte ballë furtunave të kohës; mendoi, gjithashtu, se një punë të tillë mund ta kryente familja e Mediciëve, që ishte e fortë në Firence dhe në Romë. Me këtë frymë u vu të shkruajë një seri veprash dhe, mbi të gjitha, kryeveprën e tij, "Prin-cin", që do të bënte aq bujë në tërë botën. Gjatë kohës së qëndrimit në fshat, u përpoq të hynte në shërbim të Mediciëve, por përpjekjet shkuan kot. Thuhet se Leoni X u këshillua me të mbi disa reforma që do të bënte dhe se e ngarkoi të ngrinte fortifikatat e Firences dhe, më së fundi, të organizonte ushtrinë, por pas pak kohësh Makiaveli vdiq ndoshta i helmuar. Veprat Gjatë kohës si sekretar i të Dhjetëve, puna e tepërt që kishte pasur, nuk i kishte dhënë mundësi të shkruante dhe të botonte libra, përveç disa poezive pa ndonjë vlerë letrare dhe disa shkrimeve të vogla mbi vendet që kishte vizituar si i dërguar i qeverisë. Në Shën Kashano, Makiaveli filloi të shkruante vepra me rëndësi dhe kryeveprën e tij "Princi", që do t'ia bënte të pavdekshëm emrin. "Bisedat mbi deka-dën e parë të Tit Livit" është një nga veprat më të mira të kësaj kohe. Ky libër është një traktat shkence politike, në të cilën hasen aty-këtu idetë që do të shfaqen në kryeveprën e tij. Lëndën për këtë vepër e merr nga Tit Livi dhe prej tij nxjerr disa mësim të përgjithshme, që i vlerëson me anën e shembujve të historisë së vjetër romake dhe me vërejtje që kanë të bëjnë me jetën e tij politike. Prej përfundimeve që nxjerr, disa janë morale e disa, jo. Në to ndihej ajo frymë, e cila më pas do të njihej me emrin famëkeq "makiavelizëm". Makiavelit i intereson, mbi të gjitha, përbërja dhe ruajtja e shtetit që është supreme lex (ligji më i lartë). Përpara këtyre, feja dhe morali duhet të lëshojnë rrugë. Nuk duhet biseduar, sipas tij, nëse një gjë është e mirë apo e keqe, por, nëse

është e dobishme apo jo për shtetin. Bazuar në këto parime, ai flet për mashtrime të ndershme, për poshtërsi madhështore. Ai i studion të vërtetat historike dhe shoqërore si fenomene të natyrës, dhe gjurmon midis tyre edhe ligjet. Arsyeton mbi to i qetë, me kthjelltësi mendjeje, me përpikëri fjalësh. Mendimi i tij del si i gdhendur e i kapshëm përpara syve të lexuesit. “Arti i luftës”, në këtë vepër thekson se vetëm nënshtetasit duhet të luftojnë për mbrojtjen dhe lavdinë e atdheut. Vepra ka vlera teknike. Ndërsa në vepra të tjera ka kërkuar të krijojë një shkencë të shtetit, në këtë kërkon të krijojë një shkencë të strategjisë. Si dhe në vepra të tjera, përfundimet i nxjerr nga përvoja e punëve të kohës së tij dhe nga mësimet e të vjetërve. “Historitë fjorentine” është vepra e tij e fundit (1520). Kallëzon ngjarjet duke kërkuar shkaqet. Si vepër historike nuk ka vlerë, sepse autori përpiket t’i përkulë ngjarjet për të vërtetuar parimet kryesore të doktrinës së tij dhe se, duke e marrë lëndën nga kronistë të ndryshëm, nuk i vë këta përballë njëri-tjetrit për të gjetur të vërtetën. Megjithëkëtë, kjo vepër është shkruar në përshtatje me ngjarjet e ndryshme dhe paraqet interpretime të sakta mbi kuptimin e shumë ngjarjeve. “Jeta e Kastruçio Kastrakanit” është njëfarë romani politiko-ushtarak, ku prijësi na paraqitet i shfytyruar qëllimisht, për t’i përngjarë princit të ri, ashtu siç e kishte përfytyruar autori. Makiaveli shkroi dhe dy komedi, prej të cilave ka njëfarë vlere ajo me titull “Mandragola”. Prej saj ka mbetur dhe një epistolar mjaft i pasur që hedh dritë mbi jetën, karakterin dhe idealin e tij. Por vepra që i dha famë në tërë botën Makiavelit, qoftë për mirë, qoftë për keq, është “Princi”. “Princi” është një traktat i shkurtër, në të cilin autori jep udhëzime se si krijohen, mbahen dhe zmadhohen shtetet. Duke u mbështetur në këto udhëzime, mbaron duke iu drejtuar familjes së Medičëve, që ajo familje të krijojë një shtet të madh e të fortë italian, me ushtri kombëtare, që të jetë në gjendje t’u bëjë ballë shkelësve të huaj dhe të sjellë drejtpeshim midis shteteve të mëdha europiane. Rregullat që jep autori për krijimin dhe ruajtjen e shtetit, sado të tmerrshme dhe mahnitëse, i shfaq në mënyrë sistematike, pa ngurrim, me qetësi shpirti, me stil të fortë, me fraza të holla, me fjalë të përpikta dhe, mbi të gjitha, me një gjakftohtësi ngurosëse që e lë njeriun të habitur. Shpeshherë plotëson, përcakton e shpjegon një gjykim që lexuesi e kishte parë më parë të turbullt dhe s’kishte mundur ta kapërdinte. Në këtë vepër autori shkruan nën përshtypjen e një bindjeje e të një pasioni të thellë, prandaj nuk humbet kohë të zbukurojë periodën, por përpiket ta shfaqë mendimin e tij me kthjelltësinë dhe saktësinë më të madhe të mundshme. Mendimin e tij

e shpreh të plotë, pa çarë kryet se do të ngjallë kënaqësi a neveri, duke u treguar njerëzve ligësinë dhe dobësitë e tyre dhe duke u mësuar princërve të gënjejnë, të presin në besë e të mashtrojnë për dobi të shtetit. Si model të princit të përsosur për t'u imituar, tregon Qezar Borxhian që, për të krijuar dhe mbajtur shtetin, kishte kryer një mijë e një mizori. Udhëzimet që jep, i bazon në shembuj nga koha e tij dhe nga koha e lashtë. Në bazë të udhëzimeve të tij, morali dhe feja nuk kanë kuptim; ato janë mjete të thjeshta në dorë të princit. Shteti i Makiavelit siguron fuqinë dhe të drejtat e veta, por jo të individit. Vetëm një gjë duhet të jetë e moralshme: qëllimi për krijimin dhe ruajtjen e shtetit. Për t'ia arritur këtij qëllimi, duhen përdorur mjetet e duhura, qofshin ato edhe imorale. Kjo ishte rruga, thotë, që kishin ndjekur njerëzit e mëdhenj të botës për të bërë mrekulli, kjo ishte rruga që duhej të ndiqte princi që do të krijonte një shtet të madh e të fuqishëm italian. Sa shumë na neverit në fillim me llogaritjet e tij të ftohta, aq na paraqitet idealist e simpantik nga fundi i librit, ku jep të kuptohet se të gjitha imoralitetet që ka përmendur më parë bëhen për realizimin e një ideali të lartë, për bashkimin e forcimin e një populli të madh në një shtet të fuqishëm, në bazë të parimit qëllimi justifikon mjetin. Dhe, s'ka qenë i gënjyer. Po të zhvishemi nga ndjenjat e pasionit dhe të mendojmë kthjellët dhe me qetësi, do të shohim se gjithë popujt që kanë arritur shkallë të larta fuqie dhe zhvillimi dhe kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në histori, kanë vepruar ashtu si mendonte Makiaveli, ndonëse nuk e kanë thënë. Makiaveli ka pasur burrërinë ta thotë troç me zemërçelësinë më të madhe. Vepra e tij bëri bujë të madhe në tërë botën. Emri i tij për shekuj me radhë ka qenë sinonim i njeriut të mynxyrës, tmerrit, i tinëzisë së ftohtë e të llogarit, i mashtrimit djallëzor. Me kalimin e kohës, njerëzit filluan të tregoheshin më të butë ndaj tij, të njihnin zotësinë e tij në fushën diplomatike dhe ta çmonin si njërin nga historianët dhe shkrimtarët italianë më të mëdhenj.

Korrupsioni

Korrupsioni vjen në shumë lloje dhe mund të përfshijë:

Nëpunësit publikë që kërkojnë ose marrin para në këmbin të ndonjë shërbimi;

Politikanet të cilët i abuzojnë fondet publike, u japin pozicione të punës ose kontrata të tjera sponsorëve të tyre, shokëve dhe familjeve;

Kompanitë që u japin ryshfet zyrtarëve për të marrë kontrata më të favorshme.

Korrupsioni zakonisht ndodh me diskrecion dhe në varësi të asaj se ku dhe në çfarë mënyre manifestohet, ai shpesh është mundësuar me ndikimin e bankave, avokatëve, kontabilistëve, transakcioneve jotransparente, larjeve të parave, pasurimit joproportional.

Cili është çmimi i korrupsionit?

Politik: Liritë e qytetarëve dhe sundimi i ligjit.

Shoqëror: Besimi i qytetarëve në pushtetin dhe sistemin, dhe përfshirja e tyre në sjelljen e vendimeve dhe të politikave.

Ekologjik: E drejta dhe mundësia për një mjedis të shëndetshëm dhe të ardhme të qëndrueshme.

Ekonomik: Mundësia e qytetarëve të kenë më shumë mjetet financiare, si edhe të kenë mundësi të rritin të ardhurat e tyre financiare.¹³

Zgjidhjet ligjore dhe aktet nënligjore të cilët lënë hapësirë për diskrecion gjatë rekrutimit të kuadrit në sektorin publik, si dhe gjatë avancimit dhe shpërblimit të punësuarve, procedura e papërcaktuar për përzgjedhje, llogari dhe shkarkim të drejtorëve dhe anëtarëve të bordeve drejtuese, mungesa e efikasitetit dhe efektivitetit të mekanizmave kontrolluese në procedurat për punësim (dhënia e aprovimeve dhe pëlqimeve, vendime të arsyetuar, njohja e opinionit me masat e ndërmarra gjegjësisht rezultatet nga mbikëqyrjet e zbatuara të inspektimit) shpërndarja e pagave të punësuarve në sektorin publik, mungesë e proporcionit në lidhje me të punësuarit, përdorimi i punësimeve të përkohshme si mundësi për të tejkalimin e procedurës së rregullt për përzgjedhje të kandidatëve, trajnim jo efikas dhe jo efektiv i të punësuarve në sektorin publik, përdorimi i akteve nënligjore si mundësi për punësim të kuadrove joprofessional, publikimi i shpalljeve në kohën para zgjedhjeve, formimi i organeve për vetëm një person, janë vetëm disa prej dobësive të notuar ose pika të cenuar në sistemin e nëpunësve në RMV.¹⁴

Në vitin 2020 Maqedonia e Veriut është e 106-ta në listën aktuale të Transparencës Ndërkombëtare. Në një shkallë nga 0 deri në 100 pikë (0 - shkalla më e lartë e korrupsionit dhe 100 - korrupsioni më i vogël) ka 35 pikë. Që është dy pikë më pak se vitin e kaluar (2019).

Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina qëndrojnë më mirë se Maqedonia e veriut me 36 pikë këtë

¹³ [https://transparency.mk/sq/cfare-perfaqeson-korrupsioni/\(21.01.2022\)](https://transparency.mk/sq/cfare-perfaqeson-korrupsioni/(21.01.2022))

¹⁴ https://transparency.mk/wpcontent/uploads/2021/02/vlersimi_i_cenueshmris_nga_korrupsioni.pdf, f.12

vit, ndërkaq Serbia ka 39 pikë dhe Mali i Zi me 45 pikë. Shqipëria, ashtu si Maqedonia, kanë nga 35 pikë.

Në renditjen e Transparencës Ndërkombëtare, që e bën çdo vit, në krye janë Danimarka dhe Zelanda e Re me nga 87 pikë, të ndjekur nga Finlanda me 86 dhe Singapori, Suedia dhe Zvicra me 85.¹⁵

Komercializimi i politikës

Një traditë e rëndësishme në sociologji, argumenton se roli i rritur i komunikimit masiv në politikë përfaqëson bashkëngjitjen e marrëdhënieve kapitaliste shoqërore - në veçanti marrëdhëniet e konsumit - me sferën politike. Në këtë proces politika është bërë artificiale dhe ka degjeneruar. Jürgen Habermasi ka argumentuar se “kapitalizmi i kohëve të fundit sjell manipulimin e opinionit publik përmes medias masive, artikulumit e detyruar të nevojave sociale përmes organizatave të mëdha dhe, me një fjalë, menaxhimin e politikës nga “sistemi” (cituar nga Pusey, 178, f. 90). Duke përdorur një gjuhë të ndryshme, por me thelb të njëjtë, Herbert Schilleri analizon se në kapitalizmin bashkëkohor, politikanët “i shiten” publikut, pothuaj si sapunët dhe automobilat.¹⁶ Politikat dallohen nga njëra-tjetra në varësi të qëllimit, kompleksitetit, amplitudës së zgjedhjeve apo kriterëve të vendosura, proceseve të hartimit apo mënyrave që propozojnë për zbatim. Për sektorë të ndryshëm mund të hartohen politika të posaçme. Politikat zakonisht shprehen nëpërmjet programeve, por mund të formulohen ose shpallen edhe me mënyra të tjera, si për shembull nëpërmjet fjalimit të një zyrtari të lartë të shtetit apo deklaratës për shtyp të institucionit përkatës. Për çështje specifike, që kanë të bëjnë kryesisht me menaxhimin e punëve të përditshme, politika mund të shprehet me vendime afatshkurtra, që ndryshe quhen edhe politika të vogla; për çështje strategjike apo shpërndarjen e burimeve në shkallë të gjerë, hartohen programe të gjera e të shumëfishta.

Politikat mund të marrin forma nga më të ndryshmet. Frikësim, manipulim dhe negociim klasifikohen si formë e pushtetit të fortë politik; frymëzim apo krijimi i rrjeteve të besimit klasifikohen si formë e pushtetit të butë të saj. “Inteligjencë politike” është aftësia për të matur dobësitë, pasiguritë, pëlqimet apo mospëlqimet ndaj të tjerëve dhe për t’i kthyer në instrumente personale, shumë të ngjashëm me ato që

¹⁵ <https://in7.tv/2020/01/23/korrupcioni-rmv-ja-dhe-shqiperia-te-ranguara-me-keq-ne-rajon/> (21.1.2022)

¹⁶ Brian McNair, Hyrje në komunikimin politik, UET - Press, Tiranë, 2009, f.53.

Makiaveli i quante aftësi politike, tepër të rëndësishme në instalimin dhe nxitjen e pushtetit të fortë politik.

Politikat lindin nga trysnitë politike dhe gjenden brenda një sistemi politik, qëllimi i të cilit është të transformojë “konfliktet e grupit për burime publike dhe vlera, në kurse të autorizuara veprimi që lidhen me shpërndarjen e tyre”. Politika është sistematike dhe jo e rastësishme. Ajo është synim-orientuar dhe komplekse, e koordinuar, me disa kurse veprimi dhe jo një aktivitet i veçantë dhe i izoluar. Sa më përfshirës harku i synimeve politike, aq më problematik bëhet hartimi i programit të saj, veçanërisht në shoqëritë në tranzicion apo me konflikte të ndryshme. Taylor et al (1997) shprehen në këtë formë:

“... politika është më shumë se një tekst i thjeshtë politik i shkruar. Në të përfshihen procese shumë më parë se të artikuloohen në formën e teksteve dhe procese të cilat vazhdojnë edhe pasi teksti është formuluar; ajo modifikon vlerat e pohuara, veprimet e dëshiruara dhe praktikën aktuale. Politika shoqërohet gjithmonë nga kontestimi, i cili bëhet pjesë e politikës dhe e agjendës së saj sapo formulohet, nëpërmjet inicimit të veprimeve për shkëmbime të paevitueshme që përfshihen në formulim dhe zbatim.”¹⁷ Kontestimi vjen nga vlera që njihen, nga zëra që dëgjohen ose që janë “autoritarë” në politikë apo nga ato grupe të cilët do të përfitojnë direkt si rrjedhojë e këtyre politikave.

Figura, që shfaqet bashkë me këtë sistem të makinerisë partiake plebishitare është: “bosi”. Çfarë është bos? Një sipërmarrës politik kapitalist, i cili siguron vota elektorale për hesapin e vet dhe duke marrë në sy rrezikun e vet. Si avokat ose pronar pijetoreje apo si pronar në veprimtari të ngjashme ose mbase si kredidhënës mund t’i ketë fituar ai lidhjet e tij të para. Që këndeje tjerr ai më tutje fijet e tij, derisa të jetë në gjendje “që të kontrollojë” një numër të caktuar të votave. Pasi të ketë arritur kaq shumë, hyn ai në lidhje me bosët fqinj, ngjall nëpërmjet zellit, shkathtësisë dhe para së gjithash nëpërmjet mungesës së bujës vëmendjen e atyre, që kanë arritur tashmë më shumë në karrierë dhe fillon të ngjitet. Bosi është i domosdoshëm për organizimin e partisë e ajo ndodhet e përqendruar në dorën e tij. Ai i siguron asaj në mënyrë shumë thelbësore mjetet financiare. Si i gjen ai këto mjete? Pjesërisht nëpërmjet kuotizacioneve të anëtarëve, por para së gjithash nëpërmjet taksimit të rrogave të atyre nëpunësve, që kanë marrë poste nëpërmjet tij dhe partisë së tij; pastaj nëpërmjet ryshfeteve dhe bakshisheve. Kush

¹⁷ [https://fhl.org.al/politika-politika-arsimore-dhe-vlera/\(2.1.2022\)](https://fhl.org.al/politika-politika-arsimore-dhe-vlera/(2.1.2022)).

do që të shkeli pa u dënuar një nga ligjet e shumta, ka nevojë për miratimin e heshtur të bosit dhe për këtë patjetër duhet të paguajë, përndryshe atij do t'í lindin pashmangshmërisht telashe. Por vetëm me këto nuk sigurohet dot ende kapitali i nevojshëm operativ. Bosi është i domosdoshëm si marrës i drejtpërdrejtë i parave nga manjatët e mëdhenj financiarë. Këta nuk do t'ia besonin kurrë asnjë nëpunësi të paguar të partisë apo ndonjë personi që jep publikisht llogari paratë e tyre për qëllime elektorale. Vetë kuptohet bosin me heshtjen e tij të mençur në çështje parash është njeriu i atyre qarqeve kapitaliste, të cilat financojnë zgjedhjet. Bosi tipik është një njeri absolutisht i kthjellët. Ai nuk përpiqet të fitoj nder social; “profesionisti” është i përcëmuar brenda “shoqërisë së mirë”. Ai kërkon kryekëput vetëm pushtet social, pushtet si burim i fitimit të parave, por gjithashtu dhe pushtet për hir të pushtetit. Ai punon në errësirë; ky është kontrasti i tij me liderin anglez. Atë vetë nuk e dëgjojnë të flas në publik; ai u sugjeron oratorëve se çfarë duhet të thonë në mënyrë të përshtatshme, kurse ai vetë hesht. Si rregull ai nuk merr asnjë post, me përjashtim të postit të senatorit në senatin federal. Meqë senatorët në bazë të kushtetutës marrin pjesë në akriballëkun e shpërndarjes së posteve, atëherë bosët drejtues shpesh ulen personalisht në këtë organ shpërndarës. Shpërndarja e posteve kryhet në radhë të parë sipas shërbimeve të bëra për partinë, por shumë herë hasej gjithashtu rasti kur postin e merrte ai që ofronte më shumë para dhe për poste të veçanta ekzistonin taksa të caktuara, pra një sistem i shitjes së posteve sikurse e njihnin atë shumë shpesh monarkitë e shekujve të 17 dhe 18 duke përfshirë edhe kishën shtet. Bosi nuk ka “principe” të qëndrueshme politike. Ai është plotësisht pa parime dhe pyet vetëm: cila gjë kap më shumë vota? Jo rrallë është ai një njeri i edukuar mjaft keq, por në jetën e tij private jeton zakonisht pa të meta dhe në mënyrë korrekte. Vetëm në etikën e tij politike i përshtatet ai, siç e do natyra, etikës mesatare ekzistuese tashmë në veprimtarinë politike, sikurse shumë nga ne duhet ta kenë bërë këtë edhe në sferën e etikës ekonomike, kur si të tjerët në kohën e krizave kemi blerë me shumicë ushqime që po mbaroheshin. Atë nuk e shqetëson fakti që si “profesional”, si politikan profesionist e përcëmojnë në shoqëri.¹⁸

¹⁸ <https://pdfslide.net/documents/max-weber-politika-si-profesion-shkenca-si-profesion-tre-tipat-e-paster-te.html>, f.29 (30.12.2021).

Morali Politik

Morali në politikë nuk është koncept i shprehjes për të fituar politikisht, por është një vlerë humane e cila shërben në ngritjen e vetëdijes kolektive drejt të mirës universale. Ndërkaq, morali që prezantohet në vendet e rajonit është bërë pothuaj i pavlefshëm ndaj interesit të përgjithshëm të shoqërisë, duke u marrë më shumë me çështjet, sesa me fenomenet ose interesin publik. Nga kjo farsë për të shfrytëzuar motivet vetjake, e madje për të përmbushur nevojat e tyre, thelbësisht dëmton rëndë shtetin e së drejtës dhe zhvillimin normal të shoqërisë, e cila mund të shndërrohet në niaiserie (frëngj. gomarllëk).¹⁹ Morali është dhe duhet të jetë fondamenti i politikës. E nënvizoj me emfazë, sepse në logjikën e shumicës së njerëzve ‘Morali dhe Politika’ janë apo gjenden diametralisht në kahe të kundërt. Nuk është aspak e vërtetë!

Thjesht, në këtë vend të pabegatë dhe të pabekuar, normalja na tingëllon anormale, për shkak të përbindëshave me tabela “politike” dhe me moral “numerik” që janë “zgjedhur” me dhunë.

Pyetja: “Nëse bashkëekzistenca e moralit dhe politikës është e mundshme apo jo?” – është diakronike dhe thellësisht e rëndësishme për jetën njerëzore. Ekzistuan shoqëri, si ajo antike greke, që brumosën dhe zhvilluan marrëdhënie të ngushtë mes moralit dhe politikës. Atje ku kjo bashkëekzistencë bëhej realitet, rezultati, lidhur me cilësinë e jetës së qytetarëve, ishte i suksesshëm.

Ndërkaq, në botën bashkëkohore, bashkëekzistenca e politikës me moralin është konsideruar dhe vazhdon të konsiderohet, prej më të shumtëve, si utopi.

Çfarë është “morali” në thelb? Moral është tërësia e parimeve, rregullave dhe vlerave që orientojnë veprimin. Një veprim është i moralshëm, kur subjekti e kryen pa paragjykim, pa prapamendim dhe pa marrë parasysh rrezikun e sanksioneve, apo pa prituri shpërblim.

Vlera e moralit gjendet kryesisht në përzgjedhjen e ndërgjegjshme të një veprimi me pikëreferimi të duhurën, të përshtatshmen, të vetkuptueshmen, të drejtën embrionale. Për shpërblim të vetëm, ka kënaqësinë e brendshme që mes këtij veprimi ngre shtat e mira.

Morali është marrëdhënie me tjetrin, respekt për të drejtat, nevojat dhe dëshirat e tij, që sjell për rrjedhojë besimin reciprok. Kjo do të thotë se morali nuk mjaftohet vetëm në definicionin e asaj se çfarë është e

¹⁹ [https://telegrafi.com/morali-ne-politike/\(15.01.2022\)](https://telegrafi.com/morali-ne-politike/(15.01.2022))

mirë dhe e drejtë, por kërkon dhe parashtron implementimin e së mirës dhe të së drejtës. Pa zbatimin praktik, vlera e së mirës mbetet, thjesht, në hapësirën e predispozicionit.

Politika, nga ana tjetër, është një prej fjalëve të njohura që së bashku me filozofinë dhe demokracinë na la trashëgim bota antike greke në historinë e ideve. Fjala gjen rrënjën e saj tek “politi” (qytetari) dhe politi gjen rrënjën e tij tek “poli-s” (qyteti).

Qytetin në antikitet nuk e bënë godinat dhe rrugët, por jeta e organizuar shoqërore e banorëve, mes bashkëpunimit politik, ekonomik dhe fetar të anëtarëve të tij.

Politika është mjeshtëria e autoritetit, por edhe e udhëheqjes nga autoriteti, mjeshtëria e formës mes së cilës rezultativisht dikush mund të marrë pjesë në jetën e bashkësisë, në jetën publike të vendit të tij, qoftë si drejtues apo si vartës, teksa në fund të fundit përgjegjësitë, si edhe veprimet, ndahen mes drejtuesve dhe vartësve.

Për të trajtuar teorinë politike duhet të ketë veprim politik, interesim të theksuar dhe pjesëmarrje aktive të anëtarëve të shoqërisë në jetën kolektive. Fondamenti në të gjitha momentet e mëdha të teorisë dhe veprimit politik të antikiteit ishte se, politi (qytetari) dhe poli (qyteti) do të progresonin së bashku duke mbërritur në “begati” dhe “virtyt”, dhe se njëri mes tjetrit do të bëhej “i drejtë”, i përsosur (Platoni).

Politikani, fillimisht formon personalitetin e tij dhe në vazhdim i drejtohet një grupimi, me qëllim që të ushtrojë atje aftësitë dhe karizmen e tij, duke ofruar mbështetjen e tij për të ngritur në nivel më lart bashkëhumanët e tij. Për rrjedhojë, politikani është diçka midis një shkencëtari dhe një mjeshtri, i cili ndan me të tjerë veprimtarinë e tij kreative, duke pasur parasysh sigurisht prezencën “e tjetrit” që përbën parakusht në konceptimin dhe zbatimin e veprimit të tij politik, pasi është e pamundur për dikë që të ushtrojë virtytin i vetëm.

Aristoteli në veprën e tij “Politike”, mbështet idenë se ekziston afinitet absolut mes moralit dhe politikës, pasi “poli-s” është parakusht dhe kusht i krijimit të njerëzve të moralshëm. Poli-s nuk ka për qëllim vetëm mbijetesën e njerëzve, por bashkëjetesën e organizuar dhe përsosmërisht të orientuar, që siguron jetesën. Përsosuria morale e njeriut realizohet mes një shoqërie politike, ndërsa përsosmëria e organizimit politik ka lidhje të drejtpërdrejtë me cilësinë morale të politëve (qytetarëve). Parimet e bashkëekzistencës politike i nënshtrohen atyre

morale, ndërsa arsimimi përcaktohet në thelb si edukim moral, që përgatit dhe brumos njerëz të moralshëm, politë të drejtë dhe të mirë.²⁰

Kur Sokrati një nga krijuesit e Filozofisë së Moralit, u akuzua se nuk i respektonte ligjet e Qytetit, Platoni do të reagoje ndaj asaj që ai do ta konsideronte një padrejtësi të madhe, përmes përpunimit të një teorie filozofike të drejtësisë, që hidhte bazat e një rendi politik ideal.

Meqenëse njeriu nuk mund të jetojë i vetëm dhe duhet të jetojë në komunitet, ai konsiderohej nga Aristoteli si një “qenie politike”, ku theksohej ideja se për njeriun ekzistenca politike është diçka natyrale.

Ky opinion, do të shfaqej i kontestueshëm që në momentin që organizimi politik do t’i tejkalohej dimensionet e Qytetit, për të pohuar kushtet e një shteti. Ky i fundit, pra shteti nuk mund të kualifikohet më si “natyral” dhe nevojitet të bazohet, apo të krijohej mbi një kontratë mes palëve, nga ku kemi parë shumëfishimin e teorive, që aludojnë mbi një kontratë sociale origjinale.

Në fakt, dallimi mes sferës private, pra asaj çka individit mund të pohojë si veçanti dhe karakteristikë të tij, dhe sferës publike, atë të drejtuar nga organizimi i njerëzve mes tyre, na ekspozon një kontradiktë mes kërkesave të individit (të orientuara drejt komodes, apo së mirës në veçanti) dhe atë të kolektivitetit (që shqetësohet për ndarjen e barabartë të të mirave, të paktën një ndarje në mënyrë inteligjente). Çdo organizim politik duhet në këtë mënyrë të përballojë çështjet përkatëse, që lidhen me drejtësinë dhe më në përgjithësi me moralin.

Pa organizimin politik, sigurisht që njerëzit nuk do të njohin veçse marrëdhënie të dominuara nga dhuna. Duke e përkufizuar luftën si “vazhdim i politikës, përmes mjeteve të tjera” Klausvitz sugjerohej se politika është ajo që lejon pezullimin, ose “shtyrjen për më vonë të dhunës”, duke privilegjuar argumentimin dhe debatin.

Kjo, nënkupton prezencën tek ne, apo tek anëtarët e klasës politike të një sjellje të arsyeshme, të favorshme ndaj konfrontimit të ideve, apo të vlerave. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se dhuna do të zhduket pasi ta pezullosh atë, apo ta shtysh “për më vonë” nuk do të thotë ta zhdukësh dhe shteti modern sigurisht që karakterizohet gjithashtu edhe nga fakti se zotëron monopolin e dhunës të pohuar si legjitime (ushtria, policia, etj.).

Në këtë mënyrë, instanca politike iu ndalon atyre që ajo i drejton, apo i qeveris që të jenë të dhunshëm, por nuk e privon veten aspak të

²⁰ [https://pamfleti.net/morali-politika/\(20.1.2022\)](https://pamfleti.net/morali-politika/(20.1.2022))

jetë e tillë, kur ajo e gjykon se është e nevojshme. Pra, në duart e individit dhuna është krim dhe ndëshkohet, në duart e shtetit po e njëjta dhunë është e legjitimuar. Dhe këto zgjedhje sigurisht që nuk mund t'i pranojnë, apo t'i mirëkuptojnë njësoj të gjithë ata që politika i përfaqëson për atë kohë sa ajo shqetësohet më shumë për efikasitetin, sesa për ekuilibrat që duhen mbajtur në jetën kolektive.

Një mosmarrëveshje e tillë, na shfaq në mënyrë periodike çështjen e qëllimeve politike, të pozicionuara mes ambicies për të realizuar “të mirën e përbashkët” dhe një konfirmimi të thjeshtë të këtij trupi social, i tillë siç ai ekziston.

Kontestimi, apo përçmimi ndaj politikës nuk është fenomen i shfaqur rishtazi.

Filozofi francez Bles Paskal, tek vepra e tij e botuar pas vdekjes e titulluar “Mendimet”, theksonte se nëse Platoni dhe Aristoteli kanë shkruar për politikën, kjo ishte për të rregulluar një “Spital të Çmendurish” dhe nëse kanë bërë sikur kanë folur mbi një gjë të madhe, është pasi e dinin se të çmendurit për të cilët flisnin, mendonin se ishin mbretër, apo perandorë. Ata hynin, vazhdon më tej ai, në parimet e tyre për të moderuar çmendurinë e tyre me atë mundësi sa ç’kishin...

Pra, kemi të bëjmë me fenomenin ku të qeverisurit, apo të drejtuarit akuzojnë vazhdimisht klasën politike se ajo nuk e përmbush misionin e saj veçse përmes arbitraritetit, që fsheh në fakt interesa të veçantë, apo se karakterizohet nga një mungesë orientimi e përhershme.

Që nga filozofi britanik Loku, të gjitha teoritë e “kontratës sociale” pranojnë se funksioni i saj konsiston në mënyrë esenciale që të pohojë dhe të mbrojë të drejtat e individëve: siguria, liria, prona, etj. Pohimi i këtyre të drejtave çon në mënyrë të pashmangshme në konflikt mes personave dhe vetëm duke nisur nga momenti ku ato janë të gjitha të barabarta para ligjit, politika mund të pretendojë se mund të respektojë kontratën.

Nëse, në të kundërt ligji aplikohet në mënyrë të pabarabartë dhe nëse pushteti politik cilado të jetë forma e tij favorizon disa individë në kurriz të disa të tjerëve, protesta e këtyre të fundit është e justifikuar, por ngelet ende fakti që ata duhet të kenë mundësinë që ta bëjnë të ditur këtë.

Të gjitha përpjekjet për të perfeksionuar demokracitë kanë në këtë mënyrë për qëllim t’iu garantojnë qytetarëve të drejtën e informimit dhe të drejtën e shprehjes.

Kjo supozon nga njëra anë, që klasa politike të jetë gjithnjë gati të thotë të vërtetën mbi qëllimet e saj (sigurisht që jemi shumë larg kësaj...) dhe se gjykimet e qytetarëve mund të merren parasysh. Por, kjo supozon nga ana tjetër që të mund të përcaktohen qartësisht fushat në të cilat liria e të menduarit individual mund të shprehet pa trazuar “rendin publik”, kusht ky delikat për t’u arrirë...

Por, si mund të mirëmbahet hapësira politike si hapësirë debatesh, nëse disa janë të privilegjuar dhe të favorizuar për të imponuar idetë e tyre, aktet e dhunës, etj.

Në shtetet bashkëkohore, ndodh shpesh që qytetarët fajësojnë klasën e tyre politike se nuk kërkojnë gjë tjetër veçse të përfitojnë për vete, nga ku kemi akuza të vazhdueshme për hipokrizi, gënjeshtër, pandershmëri, etj. Kjo situatë shfaq një ndarje të mundshme dhe të rrezikshme mes qytetarëve pasivë dhe vendimmarrësve dhe dëshmon gjithashtu vështirësinë për të artikuluar së bashku Politikën dhe Moralën.

Nëse e pranojmë (si Platoni) se politika mund të rregullohet përmes një teorie globale, që shqetësohet për drejtësinë dhe arsyen, ajo fiton në të njëjtën kohë një dimension moral. Por, vendimet këtu, ngelen të rezervuara vetëm ndaj një elite personazhesh kompetentë (filozofëve). Nëse, në të kundërt mendojmë si Makiaveli (“Princi”) se politika është një teknikë e kulluar, që nuk duhet të shqetësohet veçse për efikasitetin e saj, refleksioni i saj nuk duhet të numërojë veçse mjetet e ndryshme përmes të cilave është e mundur të qeveriset në mënyrë të qëndrueshme në kohë, dhe pak rëndësi ka që disa nga këto mjete mund të duken imorale. Në emër të njëfarë “realizmi” mund të pohojmë se “qëllimi e justifikon mjetin”. Çka ngelet për t’u zgjidhur është hendeku i theksuar mes të “qeverisurve” dhe qeverisë, që sistemi demokratik kërkon ta mbushë...

Ndoshta duke u përpjekur të mendojmë politikën dhe moralin në zgjatimet e tyre maksimale, domethënë në tërësinë universale, mundet të bëhet e mundur t’i pajtojmë, apo t’i bëjmë që të korrespondojnë në mënyrë afatgjate.

Filozofi gjerman Kanti, shpresonte se duke konsideruar një evolucion pozitiv të marrëdhënieve mes shteteve, mund të vendosej në të njëjtën kohë një paqe universale dhe një mbretërim i arsyes praktike mbi tërësinë e njerëzimit. Pra, duhet që marrëdhëniet ndërkombëtare të merrnin për model marrëdhëniet morale dhe sigurisht që kjo varësi mes politikës dhe moralit është e vështirë për t’u konstatuar. Ngjarjet historike të post-Iluminizmit na treguan se pushtetet, apo të paktën disa prej

tyre shqetësohen shumë pak për respektimin e qenies njerëzore dhe nuk janë të karakterizuar nga aureola e moralit.

Legjitimiteti i revoltës

Çdo pushtet është shtrëngues: ai ka për efekt krijimin e sjelljeve dhe të akteve që individët nuk do t'i kryenin aspak në mënyrë spontane. Të njohësh ekzistencën e një pushteti politik është t'i akordosh atij të drejtën për të detyruar qytetarët të ndjekin direktivat e tij, çka provokonte tashmë habinë e shkrimtarit humanist francez La Boesi (Fjalim mbi nënshtrimin vullnetar, 1576):

“Do të dëshiroja vetëm që të më bënin të kuptoja: sesi mundet që kaq shumë njerëz, kaq shumë qytete, kaq shumë kombe të mbështesin shpesh një tiran të vetëm”.

Padyshim që ushtrimi bashkëkohor i pushtetit nuk është më zakonisht ai i “tiranit”, por fakti ngelet që edhe në demokraci ngrihet pyetja e peshës së vërtetë politike që gëzojnë qytetarët.

Pra, e kemi të pashmangshëm reflektimin se qytetarët në momentin që zgjedhin të zgjedhurit e tyre, nuk kanë më mundësi reagimi kundrejt ekseseve të mundshme të pushtetit, veçse në pritje të një rrezimi përmes votës në zgjedhjet e radhës.

Por, a duhet të pranojmë se në rastet kur pushteti aktual shndërrohet realisht në një pushtet të papërbalueshëm, qytetarët duhet të kenë të drejtë të revoltohen? Edhe pse kjo e drejtë nuk figuron shprehimisht e shkruar në tekste ligjore...

Siç thekson dhe Fukoja, tepër i vëmendshëm ndaj ekseseve të politikave, se qytetarët kanë gjithnjë të drejtë të revoltohen.

Duke propozuar një konceptim tjetër të politikës, filozofja gjermane Hana Arendt kërkon të shmangë pasojat katastrofale të totalitarizmit modernë, që e transformojnë komunitetin në një masë të njëjtë, të padallueshme në karakteristika, tërësisht të nënshtruar, pasi është i privuar nga autonomia. Bëhet fjalë për të rikujtuar këtu, se politika duhet të jetë përbërja e një hapësire në mënyrë autentike publike, që krijohet nga debatet dhe hap mundësinë e një bote vërtetë njerëzore.

Në këtë optikë, pushteti bëhet një veprim i reflektuar, i dalë nga një testim dhe i shqetësuar të afirmojë kohëzgjatjen e tij, jo përmes veprimit të forcës, por duke gjetur mbështetje mbi memorien kolektive. Dhe kjo e fundit, duhet që nga e kaluara të pranojë të gjitha aspektet: të mirat po si edhe të këqijat, ato nga të cilat mund të ndjehemi krenarë po

ashtu si edhe ato, përmes të cilave ndjejmë turp apo keqardhje. Vetëm përmes një njohje të plotë të gabimeve të kryera, mundet që një pushtet të afirmohet si Liri e Përbashkët, po njësoj siç ushtrimi i mendimit në dialog mund të përbëjë një bashkësi, apo një komunitet të vërtetë dhe të nxisë realisht aderim në vlerat e tij.²¹

Feja dhe politika

Çfarë lidhesh ka feja me politikën?

Çfarë lidhesh ka feja me jetën e kësaj bote?

Raporti midis fesë dhe politikës është pyetje dialektike. Ky raport mund të bazohet në themele pozitive, të cilat ndihmojnë në realizimin e mirëqenies dhe lumturisë së njerëzimit në këtë botë, por mund të jetë raport i cili bazohet në atë që strukturat politike ta shfrytëzojnë fenë dhe autoritetet fetare për t'i realizuar interesat e tyre, si mjet për t'i kontrolluar popujt, por dhe mund të jetë raport, i cili bazohet në konfrontim.

Këto pyetje dhe të tjera, janë sa të reja po aq dhe të vjetra dhe të lashta.

Raporti mbi bazë pozitive

Kur feja është masë sipas së cilës qeveriset, atëherë raporti midis fesë dhe politikës bazohet në themele pozitive. Feja do ta ndalojë sundimtarin të bëjë padrejtësi dhe të plaçkitë pronën publike, sepse sundimtari do të jetë i vetëdijshëm se ka kufij, të cilët që ai nuk guxon t'i kalojë dhe se ekziston një gjykatë para së cilës ai do të japë llogari për veprimet e tij. Nga ana tjetër, shoqëria, e vetëdijshme për detyrat dhe obligimet e saj, nuk do t'i kalojë kufijtë. Në këtë situatë, politika nënkupton qeverisjen e shtetit në një mënyrë që është më e mira për shoqërinë. Imam Gazaliu, për këtë ka thënë: “Feja është themeli, kurse politika është kujdestari i saj: ajo që nuk ka themel është gërmadhë, kurse ajo që nuk ka kujdestar është e humbur.”

Me këtë mendim konciz, Gazaliu ka treguar se çfarë raporti duhet të ketë midis fesë dhe politikës. Politika duhet të ruajë fenë dhe të garantojë që vlerat, etika dhe rregulloret e saj të zbatohen në praktikë dhe që drejtësia të vendoset midis njerëzve, ndërsa padrejtësia, plaçkitja, dhuna dhe diktatura të parandalohen. Feja është themel dhe bazë sipas së cilës qeveris edhe pushteti edhe bashkësia.²²

²¹ <https://gazetahorizont.com/filozofia-morali-dhe-politika-p1313-180.htm>(1.1.2022)

²² <https://islampress.ch/2020/11/feja-dhe-politika-midis-pajtueshmerise-dhe-konfrontimit/>(21.1.2022)

Të shumtë janë ata që duan të fusin në fe gjithçka dhe ta përjashtojnë fenë nga gjithçka. Saqë disa prej tyre thonë: “Kurani nuk ka lënë gjë pa trajtuar, prandaj s'kemi nevojë për t'u informuar mbi fushat e tjera. Kjo, sepse dijet e tjera, ose do e mbështesin informacionin që ceket në Kuran dhe në këtë rast është humbje kohe pasi janë gjëra që dihen, ose do e kundërshtojnë informacionin e Kuranit dhe në këtë rast humbasin vlerën e tyre.”

Shumë të tjerë, mbështesin idenë që feja të përjashtohet nga gjithçka, të boshatiset dhe të mbetet thjesht një disiplinë që mund të studiohet si filozofia, historia, sociologjia etj...

Në kohë të hershme, Ibnu Rushdi (nipi i filozofit të madh) shkroi librin e tij të vyer: “Gjykimi i drejtë, për lidhjet mes sheriatit dhe filozofisë”. Në këtë libër, ai shtjellon karakteristikat metodologjike dhe funksionale të sheriatit dhe të filozofisë. Megjithatë, si sheriatit dhe filozofia ndërthuren dhe takohen në shumë pika. Në origjinë, filozofia nuk del kundër sheriatit, madje e mbështet dhe i shërben atij. Sakaq, sheriatit nuk e ndalon filozofinë, madje i përkrah mjeshtër dhe njohësit e saj.

Ebul Velid ibnu Rushd dhe jeta e tij, u japin përgjigjen e duhur të gjithë pyetjeve të ngritura në fillim të këtij artikulli. Ai ishte një filozof racional, ishte doktor mendjemprehtë, ishte fakih dhe kadi. Në mendjen e tij, ishin gatuar dhe kishin bashkëjetuar të gjithë këto profesione, pa i shkaktuar çrregullime, konfuzion dhe pasoja në jetë. Ibnu Rushdi njihte mirë mjekësinë dhe filozofinë, ishte mjek dhe njihte mirë politikën. Shumë nga dijetarët myslimanë, heqin paralele mes sheriatit dhe mjekësisë, siç thekson dhe imam Shatibiu: “Sepse Ligjvënësi (Zoti) është Doktorit suprem.”

Raporti i fesë me politikën, është si raporti i mjekësisë me njeriun. Ai është si raporti mes mjekimit, ilaçit dhe kujdesit dhe jo siç mund të shihet sot, raport konfliktualiteti dhe rivaliteti.

Profetët e Zotit kanë qenë mjeshtër të politikës dhe politikanët e parë. Dispozitat që sollën ata, përmbajnë politikën më madhështore dhe më të fisme në mbarë historinë e njerëzimit. Thotë imam Ebu Bekr Shashi në hyrjen e librit të tij me titull “Mehasin sheria” (vlerat e sheriatit) se këtë libër e ka shkruar për të treguar vlerat e sheriatit islam, përfshirjen e saj në politikën e ndershme dhe lidhjen e saj të ngushtë me logjikën e shëndoshë.

Dikush mund të thotë: “Politika e ndershme që ceket më lart, nuk është ajo politikë që njihet dhe vepron sot.”

Ashtu është dhe këtu e kanë burimin shumë probleme. Që këtu lind nevoja e politikës dhe politikanëve të shariatit dhe politikave të tij, për profetët dhe politikat e tyre.

Shumë njerëz dhe në veçanti politikanët, e kanë marrë si të qenë aksiomën se politika nuk i njeh vlerat morale dhe disiplinën fetare, gjë të cilën edhe e deklarojnë haptazi. E nga ç'sëmundje tjetër më të rëndë mund të vuajë politika dhe politikanët, sesa mungesa e stimuljeve morale dhe distancimi nga disiplina morale? A mund të ketë kjo sëmundje ilaç më efekt prurës sesa ato që ofron shiari të cilat kurojnë zemrat, mendjen dhe shpirtin?

Thotë imam Gazali: "Në udhën e tij të reformimit të njerëzimit dhe udhëzimit të tyre në rrugën e shpëtimit në dynja dhe ahiret, politika klasifikohet në katër lloje:

E para dhe më supremja, është politika e profetëve të Zotit, paqja qoftë mbi ta. Politika me të cilën u dërguan profetët, në themel ishte politikë edukative, politikë kulturore dhe politikë sociale..."

Sot, qeveritë dhe partitë politike flasin edhe për politika arsimit, edukimi, sociale, kulturore, mediatike, madje edhe politikë fetare. Ata flasin edhe për luftën kundër korrupsionit si dhe moralit të jetës publike etj... Atëherë, a konstatohet ndonjë dallim thelbësor në këtë mes?!

Vetë politika e mishëruar në udhëheqjen e shteteve dhe pushtetin e popujve, nuk ka dalë jashtë kontureve të misionit të profetëve të Zotit, politikave dhe përpjekjeve të tyre reformatore. Gjithmonë, problemi kryesor me të cilin përballëshin të dërguarit e Zotit ka qenë kufizuar kryesisht tek "elita" d.m.th shtresa politike e vendit. Nëse do të vendosnim një përkufizim të çështjeve politike, do të thoshim "Është çdo çështje ku politikanët dhe pushtetarët janë palë. Kështu, nëse shoh që politikanët janë vënë kundër profetëve, atëherë ajo është një çështje kryekëput politike ose me dimensione politike. Nëse konsiderohet politike sepse vjen nga njëra palë, po sikur përballja të vijë nga të dy palët në mënyrë të ndërsjellët? Shembull për këtë, kemi profetin Musa a.s. i cili u përball me faraonin dhe anasjelltas, ku politika profetike u përplas me politikën faraonike. A mund të dyshojë dikush se Musai a.s. nuk ishte në një rol politik dhe se po përballlej me një sfidë politike?!

Madje, kur lexojmë versetet që kanë të bëjnë me misionin e Musait a.s., e ndjejmë që misioni i tij ishte politik, ose sikur nuk ishte dërguar veçse për faraonin dhe elitën politike të Egjiptit të kohës.

Nga këto versete shkëpusim: Pas tyre, Ne dërguam Musain me shenjat Tona, te Faraoni dhe paria e tij, por edhe ata i mohuan ato. Pra, shiko si ishte përfundimi i ngatërrestarëve!”

“Më parë Ne e dërguam Musain me mrekullitë Tona dhe me një autoritet të qartë te Faraoni, Hamani dhe Karuni, por ata thanë: “Ky është magjisttar dhe gënjeshtar!” (Gafir, 23-24)

Shko te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë” (Taha, 24)

“Shkoni te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë!” (Taha, 43)

“Ne, me të vërtetë, ju kemi sjellë një të Dërguar dëshmitar mbi ju, ashtu siç ia çuam një të dërguar Faraonit,” (Muzemil, 15)

Lidhur me aktivitetin politik të Musait a.s., nuk mund të themi se ai ishte një përjashtim, pasi të gjithë profetët kanë qenë politikanë në një farë mënyre. Profeti i Zotit Sulejmani a.s., ishte burrë shteti i pasoq. Në një hadith të saktë, profeti Muhamed a.s. thotë: “Bijtë e Izraelit qeveriseshin nga profetët. Sa herë që vdiste një profet, e pasonte një tjetër. Pas meje nuk do të vijë asnjë profet tjetër, sakaq kalifët do të jenë të shumtë.”

Vetë vula e profetëve dhe te të dërguarve, është marrë me politikë me të gjithë kuptimet e kësaj fjale. Ai është marrë me politikën e propagandës dhe edukimit, me politikën e organizimit dhe projektimit, me politikën e stërvitjes dhe ekzekutivit, me politikën e themelimit të shtetit dhe udhëheqjes së tij, qeverisjen e shoqërisë dhe menaxhimin e halleve të tyre, si dhe politikat e luftës dhe të paqes.

Mendoj se nuk do të dalë dikush të më kërkojë argumente dhe shembuj konkretë për këtë që sapo citova, pasi është diçka krejt e qartë që nuk ka nevojë për diçka të tillë. Prandaj nuk po zgjatëm më shumë, me të panevojshmet.

Veç kësaj, dispozitat islame si në Kuran, sunet dhe fikhun islam, nuk kanë lënë aspekt politik pa e përfshirë, disa në mënyrë të përgjithshme, disa të tjera të detajuar. Atëherë, si është e mundur që intelektualët dhe politikanët tanë e dënojnë rreptë përzierjen e fesë në çështjet politike, saqë një nga presidentët arabë deklaroi një herë me britma e çjerrje zëri se: As feja s'ka punë në politikë dhe as politika në fe!”

Në shekujt e fundit, debati është ndezur, ose më mirë të themi beteja, është ndezur rreth raporteve mes fesë dhe politikës. Fillimisht, u përfshi Evropa nga kjo betejë e cila mori kohë të gjatë dhe shumë vonë radha i erdhi botës islame. Po çfarë ndodhi në të vërtetë?

Në Evropë dhe në shtetet perëndimore në përgjithësi, u arrit ndarja e fesë nga politika deri në një farë mase dhe mbeti ajo që mbeti. Një situatë e tillë ka lëshuar rrënjë në kulturën perëndimore dhe është diçka e pranueshme, me disa kontraste. Vitet e fundit hasim një lloj reflektimi për t'i kthyer vëmendjen dhe respektin tek feja. Ndoshta forma më e qartë e këtij orientimi, janë debatet që u zhvilluan në Evropë mbi formulimin e kushtetutës së përbashkët të Unionit Evropian dhe vendin që duhej të zinte identiteti i krishterë në të. Kështu, shumë evropianë refuzuan anëtarësimin e Turqisë për shkak se ajo është myslimane sakaq ata janë të krishterë, gjë që detyroi shumë komentues ta etiketojnë Unionin Evropian si klub të krishterë.

Kurse në botën islame, orvatjet për ndarjen e fesë nga politika në përgjithësi dhe nga qeverisja në veçanti, kanë dëshmuar - dhe vazhdojnë -beteja të ashpra nga të gjithë llojet. Këto beteja kanë dy pole: Shtetet perëndimore dhe ithtarët e tyre lokalë nga njëra anë, dhe popujt me elitën myslimane nga ana tjetër.

Në përgjithësi, të gjithë hapat dhe arritjet drejt këtij orientime, nuk kanë qenë gjë tjetër veçse operacione tepër të dhimbshme dhe të pasuksesshme. Në botën islame, eksperiencia e parë u shënua gjatë grushtit të shtetit të përgjakshëm të cilit i priu Ataturku në Turqi, me mbështetje evropiane të plotë dhe të vazhdueshme që para tetëdhjetë viteve e gjer tani. Megjithatë, a pati sukses? A pati stabilitet? Përgjigjen mund ta lexojë secili tek garda ushtarake e pamëshirshme, e cila nuk di ta heqë gishtin nga këmbëza. Të ngjashme janë testet dhe provat e bëra në të gjithë botën islame me ndryshime të pjesshme dhe formale sipas vendeve dhe kohës.

Nëse i bëjmë një përjashtim relative suksesit perëndimor, për ndarjen e fesë nga politika, sukses i merituar dhe i dobishëm, historia në përgjithësi dhe historia e botës islame në veçanti dëshmon dhe thekson lidhjen e pandarë të fesë dhe politikës. Përse të mos veprojmë si Ibnu Rushdi dhe të konfirmojmë lidhjet mes shariatit dhe politikës?

Le t'i japim secilës vendin dhe të drejtën që i takon. Le të përfitojmë nga çdo palë të mirat e saj. A nuk është kjo vëllezër shekullaristë, gjëja më e mirë, më e dobishme dhe më e paqtë për umetin tonë, e cila do i jepte fund orvatjeve të gjata për ndarjen e fesë nga shteti dhe nga politika?! Gjithsesi, kjo do të mbesë thjesht një orvatje dhe nuk do të realizohet kurrë.

Nëse nuk u pëlqen metodologjia e Ibnu Rushdit (metodologjia e mendjes dhe filozofisë) atëherë adaptoni metodën demokratike,

mbrojeni të drejtën e popujve tuaj për të zgjedhur si të duan, edhe kur ata preferojnë sheriatin dhe bashkimin mes fesë dhe politikës.

Në fund, mbetet të theksoj se: Ndërhyrjet e fesë në çështjet politike mbetet e rrethuar nga rreziqe dhe shkarje të shumta. Bazuar mbi këtë, mbetet çështje e refuzuar, relativisht me të drejtë.²³

Përgjatë zhvillimit historik të Islamit si fe, si kulturë dhe civilizim, shteti ka luajtur rol shumë të rëndësishëm. Muqtedar Khan, në artikullin e tij të njohur “What is Political Islam” përshkruan momentet e ndjeshme nga ku zënë fill lëvizjet e para pan-islamike. Ai thotë se që nga fillimi i epokës koloniale dhe i dominimit perëndimor mbi vendet myslimane e deri më sot, shumë intelektualë dhe studiues myslimanë qajnë për humbjen e Perandorisë, fuqisë dhe lavdisë së dikurshme muslimane. Megjithatë nuk ka konsensus për atë se ç’ishite arsyeja kryesore e rënies së muslimanëve, shuarja e Perandorisë Osmane, rrjedhimisht shfuqizimi i Halifatit Islam në vitin 1924, është momenti kryesor kur fillon nxitja në psikikën myslimane për një rimëkëmbje të mundshme. Shumë lëvizje Islame që atëherë u shfaqën me qëllimin e qartë për ringjalljen e ymetit mysliman dhe rivendosjen e tij në pozitën e lavdishme të kaluar. Ç’është e vërteta, edhe para se kalifati të zhbëhej, nëpër disa shoqëri muslimane të kolonizuara, kishte filluar formimi i rezistencës kundër kolonizatorëve. Në të gjitha këto lëvizje, Islami ishte faktor koheziv dhe po ndikonte në vetëdijen shoqërore të atyre vendeve.

Gjeneza historike dhe fillet substanciale të Islamit politik

Para se të flasim për Islamin politik në kuptimin që e njohim sot, është e udhës të përmendim disa momente të rëndësishme që ndërlidhen me paraqitjen e kësaj ideologjie fetare-shoqërore-politike. Natyrisht, duke ritheksuar se Islami është feja e ardhur nga Zoti nëpërmes Shpalljes tek Muhamedi a.s., ndërsa Islamizmi është ideologjia që thirret në emër të Islamit, që përdor fenë islame si bazë të veprimit të saj politik, dhe e cila, në literatura të ndryshme botërore quhet Islam politik. Siç do të shohim më vonë, rrënjët e Islamit modern politik datojnë në shekullin e 19, e sidomos në shekullin e 20.

Lëvizjet e para pushtuese të fuqive koloniale evropiane drejt vendeve muslimane fillojnë në shekullin e 17, ndërsa kulmin e arrijnë në shekullin 20. Në fillim të shekullit 20, në Lindje të Mesme, në Indo-Kinë

²³ [http://ardhmeriaonline.com/artikull/article/feja-dhe-politika/#.YesYuv7MLIU\(21.1.2022\)](http://ardhmeriaonline.com/artikull/article/feja-dhe-politika/#.YesYuv7MLIU(21.1.2022))

dhe në Azinë Qendrore mbesin vetëm tri shtete muslimane të njohura ndërkombëtarisht: Perandoria Osmane, Persia dhe Afganistani. Gjatë kësaj kohe, fuqitë evropiane u shquan jo vetëm për nga dominimi i hapur politik dhe ekonomik, por edhe për nga “fitoret” e mëdha që korrnin mbi paradigmat fetarë dhe kulturorë të botës islame. Si përgjigje ndaj gjithë kësaj, paraqiten lëvizjet e para reformiste duke kërkuar kthim në vlerat islame si një model i rezistencës dhe i rimëkëmbjes islamike.

Kështu, rezistencat e para kundër fuqive evropiane në Lindje të Mesme u organizuan nga bashkësitë sufiste. El-Haxh Umar Tall, Shejhu i tarikatit Tixhani, udhëhoqi rezistencën ndaj kolonizuesve francez në Afrikën Perëndimore, në Guinenë e sotme dhe Mali. Usman Dan Fodio, një anëtar i tarikatit Kadiri, udhëhoqi rezistencën ndaj kolonializmit britanik në fund të shekullit të 18-të dhe organizoi muslimanët e Senegalit, Malit, Çadit, Republikës së Afrikës Qendrore dhe Sudanit në një kalifat të veçantë të quajtur Sokoto. Ky kalifat mbijetoi për gati një shekull. Në Algjeri, rezistenca e gjatë ndaj kolonizatorëve francez u drejtua nga Emir Abdulkadir Xhezairi, Shejhu i tarikatit Kadiri. Imam Shamil Dagestani, Shejh i tarikatit Nakshibendi, udhëhoqi një çerek shekulli rezistencën ndaj okupatorit perandorak rus në Kaukaz, duke arritur të bashkonte fiset ndërluftuese të myslimanëve kaukazianë dhe të shfuqizonte gjakmarrjen. Omer Mukhtar, Shejhu i tarikatit senusian, organizoi dhe udhëhoqi një lëvizje rezistence ndaj okupimit italian të Libisë për gati njëzet vjet, derisa u arrestua dhe u var publikisht në vitin 1931.

Të gjitha këto lëvizje, rezistenca dhe grupime fetare-politike janë rezultat ose i pakënaqësive ndaj politikave vendore të atëhershme, ose drejtpërdrejtë luftonin për largimin e fuqive evropiane nga Lindja e Mesme dhe vendet tjera muslimane.

Çfarë është Islami politik?

Tamara Sonn shkruan se Islami politik është interpretimi i Islamit si një burim i identitetit dhe veprimit politik. I referohet një game aktivitësh dhe individësh që mbështesin formimin e një shteti dhe shoqërie në përputhje me parimet islame. D.m.th., i referohet përdorimit të Islamit si një burim i pikëpamjeve dhe koncepteve edhe politike.

Në rrafshin historik, termi “Islami politik” është një format i rilindjes islame i filluar në dy shekujt e kaluar. Disa e përdorin termin “Islamizëm” për të përshkruar të njëjtin fenomen. Ky term i referohet përgjithësisht çdo interpretimi të Islamit që shërben si bazë për identitetin politik dhe veprimeve tjera të ngjashme me te. Më konkretisht, i

referohet lëvizjeve që përfaqësojnë mobilizimin politik modern të muslimanëve në emër të Islamit, trend ky i shfaqur në fund të shekullit të 20-të. Megjithatë, jo të gjitha lëvizjet e ringjalljes islame mund të karakterizohen si Islam politik. Martin Kramer përmend Tabligi Xhema'at dhe thotë se, edhe pse kjo lëvizje ishte zgjeruar shumë në Indinë veriore në vitet e para të shekullit 20, ajo shmang me vendosmëri aktivizimin në politikë. Gjithashtu, ka edhe disa vëllazëri sufiste të cilat kishin shfaqur dinamizëm në atë kohë, por, pa synime e programe politike. Për më tepër, një numër jo i vogël i muslimanëve janë të përfshirë në shumë veprimtari politike që nuk përfshihen në diskutimet e Islamit politik. Kështu, termi "Islami politik" zakonisht përdoret për të identifikuar një lloj specifik të programit politik dhe nuk është një etiketë gjenerale për çdo aktivitet politik në botën muslimane.

Shikuar nga perspektiva e një numri jo të vogël të studiuesve muslimanë, termi "Islam Politik" është problematik për disa arsye. Sipas tyre, ky term automatikisht nënkupton se ka Islam të pjesshëm, të copëtuar. Ata thonë se Islami është një tërësi që përfshin të gjitha sferat e jetës. Pra edhe politikën. Muhamed Hashim Kemali shkruan se në traditën islame, ekziston një degë shkencore në të drejtën islame që quhet "Es-sijase esh-sher'ijah". Ajo synon "vendosjen e rregullave dhe ligjeve që janë në përputhje me Sheriatin, me qëllim të arritjes dhe ruajtjes së interesit publik dhe parandalimin e dëmit ". Sipas Kamalit dhe disa të tjerëve, muslimanët duhet, për aq sa është e mundur, të shmangin përdorimin e frazës "Islami Politik", e cila është përhapur si rezultat i ndikimit të literaturës perëndimore në shkencat islame.

Gjithsesi, "Islami politik" si term u prezantua për herë të parë nga Arthur Jeffery në 1942. Manifestimet e organizuara politike të ringjalljes islame u ngritën si rezultat edhe i dështimit të lëvizjeve laike-nacionaliste në pjesën më të madhe të botës muslimane në mesin e shekullit të kaluar. Entuziazmi i lidërshiptit dhe programet nacionaliste të viteve 1960-ta, u zbehën nga ngecja ekonomike dhe pengesat e ndryshme politike. Gjithashtu e sidomos disfata e ushtrive arabe në luftën "gjashtë ditore" kundër Izraelit të vitit 1967 ndikuan shumë në ngjarjet që do të pasojnë në botën muslimane. Pas kësaj lufte, grupet e reja me identifikime më të qarta islame filluan të zëvendësonin të majtët radikalë si zëra të opozitës politike. Domethënë, fenomeni bashkëkohor i referuar si Islam politik (ose Islamizëm) ka ekzistuar për më shumë se një shekull, por literatura shkencore me të fillon të merret pas viteve 1960.

Kjo për shkak të zhvillimeve rajonale që kishin lënë nën hije dukshmërinë e islamikëve, si, pushtimi britanik dhe francez i tokave të Lindjes së Mesme pas shembjes së Perandorisë Osmane, rrjedhimisht, pas Luftës së Parë Botërore. Pastaj, dekolonizimi i rajonit pas Luftës së Dytë Botërore dhe luftës indigjene për pavarësi. Ajo çka bie në sy përgjatë kësaj periudhe, është fakti se në këto kohë të trazuara, islamistët nuk ishin më shumë se lojtarë marginalë në një rajon të mbizotëruar ideologjikisht nga forcat laike-nacionaliste. Literatura shkencore e asaj kohe reflektonte këtë realitet dhe për këtë arsye dominohej nga libra dhe artikuj me gjuhë dhe përmbajtje nacionaliste arabe.

Nga fundi i viteve 1970-ta, pushtetarët arabë të shtyrë nga rrethanat e reja që po krijoheshin në rajon, kishin filluar përdorimin e disa shprehjeve burimore islame, që në fakt nuk ishin tradicionale deri atëherë. Andaj terminologjia e përdorur për fenomenet e karakterizuara si Islam politik, ndryshon shumë midis studiuesve. Varësisht prej ekspertëve që merren me te, dhe varësisht nga prizma prej së cilës i qasen problemeve të shekullit 20 të botës arabe. Kështu, studiuesi amerikano-hebre për Lindje të Mesme, Martin Kramer në vitin 1980 e përdori termin “Islam politik” për t’i shtjelluar ngjarjet dhe prapaskenat e tyre që ndodhën në Lindje të Mesme. Disa studiues të tjerë përdorin termin “Islamizëm” për të njëjtën grup fenomenesh. Ta zëmë, amerikani me prejardhje armene, Richard Dekmejian ishte ndër të parët që vendosi politizimin e Islamit në kontekstin e dështimit të qeverive laike arabe, megjithëse ai përdor termat islamizëm dhe fundamentalizëm (në vend të Islamit politik). Në vitin 1995, Dekmejian trajton fundamentalizmin dhe islamizmin si formate të ngjashme dhe të dala nga ideja e Islamit politik.

“Islami politik” ka kuptime të ndryshme. Në vitin 2003, Dekmejian, shkroi se Islami politik mund të konsiderohet gjithashtu një tautologji, sepse askund në botën islame feja nuk është e ndarë nga politika. Siç thamë pak më parë, Dekmejian është i pari që tha se politizimi i Islamit i ka rrënjët tek dështimi i qeverive laike muslimane. Gjithashtu, fraza “Islami politik” përdoret edhe si përshkrim i lëvizjeve apo grupeve që punojnë për ringjalljen e gjerë fundamentaliste islame, që shoqërohet me një agjendë të veçantë politike. Mukter Khan përfshin në Islamit politik të gjitha lëvizjet islame që promovojnë një sistem politik të bazuar ekskluzivisht në parime islame ku çdo mysliman duhet t’i ndjekë ato.

Në botë sot janë të shkruar me qindra libra e të botuara me mijëra studime rreth Islamit politik. Në këtë rrafsh, dhe jo vetëm, shqiptarët janë ndër të më varfrit. Për shkak të misionit që ka si dhe për arsye të

ndryshme politike e strategjike, Islami politik është studiuar nga rrafshë të shumta dhe është shtjelluar nga pena të mprehta intelektuale. Janë bërë studime për emërtimin që ka, për përmbajtjen dhe rrezikshmërinë ndaj botës perëndimore e sidomos për lidhjet (e mundshme) mes Islamit si fe dhe Islamit politik si ideologji. Gjithashtu, studiues të tërë përdorin terma të ndryshëm përshkrues për të dalluar rryma të ndryshme ideologjike brenda Islamit politik, si konservator, progresiv, militant, radikal, xhihadist, etj. Shumica prej tyre e shohin Islamin politik një instrument për ringjalljen islame globale dhe madje edhe unifikimin politik të gjithë muslimanëve. Mohammed Ayoob nënvizon se politikën, shtetet apo hilafetet islamike nuk janë loja e fundit e as fundi i lojës. Ato konsiderohen vetëm mjete dhe instrumente të ringjalljes globale islamike. Marrë në përgjithësi, lëvizjet politike islame mund të ndahen sipas mjeteve që i përdorin për të realizuar qëllimin e tyre të parë - politikën islame. S'do mend se, nga ky këndvështrim, ekzistojnë dy lloje; 1) ata që kërkojnë impelementimin e politikës islamike përmes forcës dhe dhunës, madje edhe terrorizmit, dhe 2) ata që e kërkojnë atë përmes mjeteve paqësore duke përfshirë proceset demokratike. Ata që përdorin forcën në të shumtën e rasteve quhen xhihadistë, ndërsa ata që nuk përdorin forcë identifikohen si islamistë.

Të përmendim edhe këtë: Termi “Islami politik” nuk synon periudhën e hershme islame. Ka të bëjë kryesisht me proceset dhe aktivitetet politike të bazuara në Islam nga shekulli i 19 e deri në ditët e sotme. Pra, përdoret për të përshkruar platforma divergjente, disa herë konfliktuozë ideologjike që përmbajnë platforma fetare islame në programet e tyre. Domethënë, që e shohin Islamin si një potencial politik që mund të ndikojë në të ardhmen e shoqërive dhe politikave muslimane nëpër botë. Sidoqoftë, shumica e analizave rreth Islamit politik që në mënyrë të qartë përpiqen të vlerësojnë potencialin e tij të ardhshëm, përqendrohen në karakteristikat e tij të lindura si një ideologji politike me prirjen për të mobilizuar ithtarë për qëllime të ndryshimit të regjimit ose transformimit shoqëror, ose të dyjave. Prandaj, këto analiza përqendrohen kryesisht në natyrën e qenësishme dhe kontradiktat e brendshme të Islamizmit. Vetëm një pjesë e vogël e shkrimeve mbi Islamin politik përpiqen në mënyrë të qartë të analizojnë ndikimin që mund të kenë variablat e jashtëm të Islamit politik në perspektivat e ardhshme të Islamizmit dhe të muslimanëve në përgjithësi.²⁴

²⁴ [https://observer.al/cfare-eshte-islami-politik/\(5.1.2022\)](https://observer.al/cfare-eshte-islami-politik/(5.1.2022))

Conclusion

Avoiding the above-mentioned Aristotelian restrictions on certain groups, genders and social strata, the most preferred concepts of the relationship between morality and politics are the Aristotelian and the Kantian concept. Aiming not at ideal final arrangements, nor at the use of any means for obtaining and maintaining power, the Aristotelian type of ethics does not intend to use unreasonable means. It relies on the reason and good will of the people.

Kant talks about the fundamental law of practical reason in his book "Critique of Practical Reason" as follows: "Handle so, daß die Maxime deines Willens jederzeit zugleich als Prinzip einer allgemeine Gesetzgebung gelten könne". (Act in such a way, that the maxim of your will may at all times be valid as a principle of general legislation"). This is the categorical imperative that can regulate fair relations in a free and democratic society. This is the categorical imperative that politics and society must adhere to in order to strike a stable balance between politics and morality. There is no need to go further.

The contemporary ethical conception also posits the need to take responsibility for action. Positive skepticism in political institutions and the norms approved by them is especially important. The contemporary citizen must have a dose of mistrust constantly: because it determines the control of power and the rulers. State institutions need instances of control and division of power: legislative, executive and judicial. This separation must not only be formal, but real. Skepticism not only protects the citizen from injustices that the rulers may "not see", but also helps the ruler to govern correctly because of the fear of not voting again. These mechanisms, which may seem conflicting, in really play a protective and corrective role. Contemporary ethical politics today does not only speak of responsibility, but also of conscience, institutional accountability and social well-being.

The lack of morality in politics creates moral anarchy as well as many unknown and unexpected things in society. Politics must constantly reexamine its relationship with morality. It must return towards morality. Politics should not be afraid to return towards the moral and establish a stable balance between morality and politics. There are a number of moral concepts, which have absolute value in politics: keeping promises, avoiding lies and deception, consensus on topics of national interest, respect for real reports brought by the election results,

preservation of the system of national values, sharing of power according to the degree of support from voters, etc. No more applies to these premises than common human reason would say Kant.

A democratic society needs morality in politics, for calm, for mutual respect. Politics has a meaning and a purpose. Its purpose is to guarantee of human rights, of each person separately, to fight against poverty, to avoid conflict and well-being. The creation of a social welfare state remains a goal and orientation of the political mind.

Recensentë:

Dr. Ardian Muhaj

Prof. Dr. Ferat Polisi

Literatura e përdorur:

Vetlesen, J. Arne: *Çka është etika*, Shkupi, Shkup, 2019.

Baccarini, Elvio: *Gjykimet morale*, Qendra Kulturore Kroate , Rijeka, 1994.

Bennett, William, J.: *The Book of Virtues* , Simon & Schuster, Nju Jork, 1993.

Bennett, William, J.: *The Moral Compass* , Simon & Schuster, Nju Jork, 1995.

Berkenkamp, Lauri - dr. Steven C. Atkins: *Naucite djecu lijepom ponasanju*. Vodic Idemo roditelji!, Marjan tisak, Split, 2003.

Bono de, Eduard: *Mësoni fëmijën tuaj si të mendojë*, Libri Kombëtar, Beograd, Alfa, 1995.

Bratanic, Marija: *Paradoksi Odgoja* , Kontributi kroat nga të gjitha palët , Zagreb, 2002.

Bratanic, Marija: *Susreti u nastavi* , Skolska knjiga, Zagreb, 1997.

Crisp, Roger - Michel Slote: *Virtue Ethics* , Oxford University Press, Nju Jork, 1997.

Davis, Michael: *Etika dhe Universiteti* , Londër - Nju Jork, Routledge, 1999.

Damjanovski, Anatolij: *Studenti në mësimdhënie* , Prosvetno delo, Shkup, 1989.

Damon William: *Parathënie e botimit të vitit 1997* , në Jean Piaget: *The Moral Judgment of the Child*, Free Press Paperbacks, New York, 1997, pp. 4-9.

Davidson, Philip - James Youniss: *What Comes First: Morality or Identity*, në: *Handbook of Moral Behavior and Development*, vëll. I: *Theory*, Lawrence Erlbaum Associates Publishers, Nju Xhersi, 1991.

Devjak, Tatjana: *Etika në arsimin shtetëror në shkollat fillore, Ligji i Republikës së Sllovenisë për Solidaritetin*, 2002.

Descartes, Rene: *Një diskutim shkencor i metodës se si ta drejtojmë mendjen tonë si duhet dhe të kërkojmë të vërtetën në shkencë*, përkthyer nga Dr. Kiril Temkov, Epoha, Shkup, 1996.

Donaldson, Margaret: *Um deteta*, Zavod za uzbekenike i nastavna sredstva, Beograd, 1988.

Dostojevski, Fjodor: *Krim dhe ndëshkim*, përkthyer nga Mukades Mançe, Fan Noli, Tiranë, 2018.

Djordjevic, Jovan - Nikola Potkonjak: *Pedagogjia*, Peto dopunjeno izdanje, Naucna knjiga, Beograd, 1990.

Djordjevic, Jovan, *Savremena nastava, organizacija i oblici*, Naucna knjiga, Beograd, 1981.

Gjuriq, Milos, *Historia e etikës helene*, BIGZ, Beograd, 1976.

Facione, Peter A. - Donald Scherer - Thomas Attig: *Ethics and Society*, Prentice - Hall Inc., New Jersey, 1991.

Feezel, Randolph M. - Curtis, L. Hancock: *Si duhet të jetoj?* Biseda filozofike rreth jetës morale, Paragon House, Nju Jork, 1991.

Paulo Freire: *Dialogu dhe Edukimi*, Jeta Kulturore, 4/2003, f. 29

Furlan, Ivan: *Upoznavanje, ispitivanje i ocenjivanje učenika*, Pedagogosko-knjizevni zbor, Zagreb, 1964.

Gros, Robert: *Decak i devojcica*, Logos Art, Beograd, 1988.

Heidbrink, Horst: *Psikologjia e jetës morale*, Portali, Pragë, 1997.

Hill, V., Brian: *Edukimi i vlerave në shkollat australiane*, Këshilli Australian për Kërkime Arsimore Ltd, Melburn, 1995.

Kamçeva-Lakinska, Fisnike: *Puna e pavarur e nxënësit në mësimdhënie*, Botim i dytë i plotësuar, Daskal Kamçe, Kavadar, 1996.

Kant, Immanuel: *Kritika e mendjes praktike*, përkthyer nga Dr. Kiril Temkov, Metaphorum, Shkup, 1993.

Kant, Immanuel: *Edukimi i fëmijëve*, Usce, Beograd, 2002.

Kasami, Kujtim: *Ndryshimet shoqërore dhe globalizimi*, Furkan ISM, Shkup, 2021.

Kapor-Stanulovic, Nila: *Na putu ka odraslosti*, Zavod za uzbekenike i nastavna sredstva, Beograd, 1988.

Küng, Hans: *Etika dhe Edukimi Global*, në: *E ardhmja e Teologjisë*, ed. Miroslav Wolf - Carmen Krieg - Thomas Kucharz, William B. Eerdmans Publ. Comp., Cambridge, 1996, pp. 267-283.

Kurtines, William M. - Jacob L. Gewirtz: *Handbook of Moral Behavior and Development*, Volume 1: *Theory*, Lawrence Erlbaum Associates Publishers, New Jersey, 1991.

Kurtines, William M. - Jacob L. Gewirtz: *Handbook of Moral Behavior and Development*, Volume 2: *Research*, Lawrence Erlbaum Associates Publishers, New Jersey, 1991.

Kohlberg, Lawrence: *The Philosophy of Moral Development*, Harper & Row Publishers, Nju Jork, 1981.

Legrand, Louis: *Moralna naobrazba danas*, Educa, Zagreb, 2001.

Lencz, Ladislav - Olga Krzova: *Materiali Metodicky k predmetu Eticka vychova*, Metodicke centrum v Bratislave, Bratislavë, 1993.

Lozanovski, Jovan: *Edukimi etik në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë*, temë e magjistraturës (mentor dr. Kiril Temkov), Fakulteti Filozofik, Shkup, 1999.

Lozanovski, Jovan: *Format e punës, metodat dhe mjetet në mësimdhënien e Etikës në shkollat e mesme*, disertacion i doktoraturës (mentor dr. Kiril Temkov), Fakulteti Filozofik, Shkup, 2001.

Lozanovski, Jovan: *Metodologji e re për etikën e të nxënët*, "Fillimi", Shkup, 2003, nr. 219, f. 36-37.

Josip Marinkovic: *Metodika nastave filozofije*, Zagreb, 1983, f. 43

Minçeva, Branka: *Etika universale dhe vlerat e saj*, Punimi i magjistraturës (mentor PhD Kiril Temkov), Fakulteti Filozofik, Shkup, 2005.

Mionouinovi, *Љbiljana : Nivelet njohëse dhe afektive në zhvillimin moral*, Prosveta, Beograd, 1988.

Miriç, Jovan: *Zhvillimi i mendimeve morale*, Kalekom, Beograd, 2001.

Nikçevska, Gordana: *Karakterit etik i mësuesit*, Punimi i magjistraturës (mentor Dr. Kiril Temkov), Fakulteti Filozofik, Shkup, 2001.

Pavicevic, Vuko: *Bazat etike*, Dizajn grafik i Beogradit, Beograd, 1974.

Enciklopedia pedagogjike, I-II, Nikola Potkonjak dhe Pero Simlesa, Zavod za uzbenike i nastavna sredstva, Beograd, 1989.

Pecovic, Miroslava: *Ura kultura*. Udhëzues për akomodimin (dysHEME) për vizita në shtëpi nga 6-7 deri në 12 vjet, Fakulteti i Mjekësisë, Beograd, 2000.

- Pejakovic, Samuilo - Otasevic, Vujadin: *Zhvillimi i mendimeve etike dhe moralit Ponasanja*, Prosveta, Nish, 1999.
- Phillips, DZ - Mounce, HO: *Praktikat morale*, Routledge & Kegan Paul, Londër, 1969.
- Peshevska-Zarevska, Ollga: *Rinia dhe edukimi etik*, "Start", Shkup, 2003, nr. 220, f. 38-39.
- Pijaze, Zan: *Epistemologjia nauka o coveku*, Nolit, Beograd, 1979.
- Jean Piaget: *The Moral Judgment of the Child*, Paperbacks, Free Press, Nju Jork, 1997.
- Piaget, Jean: *Zhvillimi i inteligjencës*, Prosvetno delo, Shkup, 1988.
- Purtill, Richard, L.: *Thinking About Ethics*, Prentige Hall Inc, New Jersey, 1976.
- Robinson, Dave - Garratt, Chris: *Ethics for Beginners*, Icon Books Ltd, Kembrixh, 1996.
- Singer, Peter: *A Companion to Ethics*, Blackwell Publishers Ltd, Oxford, 1991.
- Smith, Richard - Standish, Paul: *Teaching Right and Wrong*, Trentham Books, Londër, 1997.
- Stevanovi, Borislav: *Mësimi dhe kujtesa*, Biblioteka Pedahosha, Shkup, 1953.
- Strongman, KT: *Psikologjia e Emocionit*, John Wiley & Sons Ltd., Londër, 1973.
- Spock, Benjamin: *Një libër për prindërit*, Emas, Sofje, 1998.
- Stamatov, Rumen: *Psikologjia e fëmijëve*, Shtëpia Botuese Hermes, Plovdiv, 2001.
- Temkov, Kiril: *Lufta për edukim etik*, "Fillimi", Shkup, 2003, nr. 218, f. 36-37.
- Temkov, Kiril: *Alfabeti ekologjik*, Shkup, 2003.
- Temkov, Kiril: *Etika*, Epoka, Shkup, 1998.
- Temkov, Kiril: *Etika sot*, Epoka, Shkup, 1999.
- Temkov, Kiril: *Etika - lënda arsimore*, "Nova Makedonija", 11.05.1998.
- Temkov, Kiril: *Etika për të rinjtë*, Shkup, 2001.
- Temkov, Kiril: *Etika për më të rinjtë*, (tregime të botuara në "Nova Makedonija" - *Kolibri*), shtator 2002-maj 2004.
- Temkov, Kiril: *Etika për shkollën e mesme II klasë*, Prosvetno delo, Shkup, 2004.
- Temkov, Kiril: *Etika për shkollën e mesme III-vjeçare*, Prosvetno delo, Shkup, 2004.

- Temkov, Kiril: *Fjalor etik për të rinjtë*, Shkup, 2001.
- Temkov, Kiril: Lidhja më e afërt, "Rodec", Shkup, nr. 1, 2003, f. 9.
- Temkov, Kiril: *Edukata etike sot*, "Vospitanie", Shtip, nr. 1, 2001, f. 40-49.
- Teodosic, Radovan: *Pedagogjia*, Instituti për nxjerrjen e kurrikulës, Sarajevë, 1957.
- Tezak, Dubravka - Obradovic-Cudina Mira: *Price o dobru, price o zlu*, Skolska knjiga, Zagreb, 1996.
- Thiroux, Jacques: *Etika - Teori dhe Praktikë*, Prentice Hall Inc, Simon & Schuster, Nju Xhersi, 1995.
- Todorov, Cvetan: *Mi i drogës*, Narodna Biblioteka Srbije, Beograd, 1994.
- Topuzoska, Ljubica: *Edukimi etik në mësimdhënien në klasë*, Punimi i magistraturës (mentor PhD Kiril Temkov), Fakulteti Filozofik, Shkup, 2004.
- Torbovska-Smilevska, Ilinka: *Etika si lëndë në shkollat fillore*, teza kryesore (mentor Kiril Temkov, PhD), Fakulteti Filozofik, Shkup, 2002.
- Trnavac, Nedeljko - Dordevic, Jovan: *Pedagogjia*, Naucna knjiga, Beograd, 1992.
- Vujicic, Vladimir: *Zgjatjet dhe reagimi moral*, Libri shkollor, Zagreb, 1981.
- Vukasovic, Ante: *Etika, morali, liria*, Skolska knjiga, Zagreb, 1993.
- Vukasovic, Ante: *Moralni odgoj*, Liber, Zagreb, 1974.
- Vuk-Pavlovic, Pavao: *Filozofija odgoja*, priredio Milan Polic, Hrvatska sveucilisna naklada, Zagreb, 1996.